



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. l.faq Brej. stratiën Nr. pages	02
Nr. Prot. Bj. Prot. Prot. No.	06-02/3102/2
Data Datim Date	28.07.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 26.07.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-1111/21, për zyrtarin e lartë z. Vehbi Miftari, për shkak se është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik me dorëheqje nga pozita e menaxherit në biznesin privat.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Vehbi Miftari, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Rasti është hapur sipas kërkesës së zyrtarit të lartë z. Vehbi Miftari, i cili ka pyetur nëse paraqet situatë të konfliktit të interesit fakti që është emëruar Këshilltar i Presidentes së Kosovës dhe njëkohësisht është edhe mësimdhënës në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" (bartës i programit). Lidhur me këtë kërkesë është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç'rast pas sqarimeve që Agjencia kundër Korrupsionit i ka dhënë zyrtarit në fjalë se çështja e referuar nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI-së, por duhet të trajtohet dhe zgjidhet sipas legjislacionit përkatës të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", i njëjti ka njoftuar se ka bërë zgjidhjen e situatës bazuar në legjislacionin në fuqi të këtij universiteti.

Ndërkohë, gjatë shqyrtimit të lëndës është identifikuar se zyrtari i lartë z. Vehbi Miftari menaxher në një biznes privat, me ç'rast Agjencia kundër Korrupsionit i ka kërkuar të njëjtit që të tërhiqet pasi që një situatë e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se: "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare

dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Zyrtari i lartë ka deklaruar se nuk ushtron veprimtarinë në këtë biznes por emri i tij ka mbetur i evidentuar në regjistrat e ARBK-së nga viti 2006, si dhe ka theksuar se pronarja e biznesit është jashtë vendit por që do kërkoj menjëherë që të lirohet nga detyra e menaxherit, përkatësisht ka deklaruar se, citoj nga deklarata e tij: *“Ju informoj edhe një herë se unë nuk e kam ushtruar kurrë këtë pozitë dhe, madje, nuk kam qenë në dijeni se emri im figuron si përfaqësues i kësaj kompanie (për të cilën, po kështu, nuk di nëse është aktive)”*. Më pas z. Vehbi Miftari ka dërguar dëshmitë se ka ndërmarrë veprime për të t’u tërhequr nga kjo pozitë, ashtu që i njëjti kërkesën për dorëheqjen e tij nga pozita e menaxherit të kompanisë e ka dërguar tek biznesi, si dhe me këtë kërkesë e ka njoftuar edhe ARBK-në (DPKI-06-2987/22).


Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia kundër Korrupsionit erdhi në përfundim se zyrtari i lartë z. Vehbi Miftari, ka shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, pasi që ka dhënë dorëheqje nga pozita e menaxherit të biznesit privat, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.3 të LPKI-së. Me këtë rast z. Vehbi Miftari (deri sa mbanë pozitë të zyrtarit të lartë publik) nuk ka të drejtë që të ushtroj asnjë lloji detyre apo aktiviteti si menaxher i biznesit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


 Yll Buleshkaj
 Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit